




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, www.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Në bazë të nenit 38.1 shkronja c) dhe e) dhe nenit 39.1 të Statutit të Komunës së Gjilanit, Kërkesës së Iniciativës Qytetare, banorëve të fshatit Uglarë, nr.12-464-15858 të dt.06.12.2010, si dhe bazuar në Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa të 22.03.2011, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 29.03.2011, miratoi këtë:

V E N D I M

për dhënien në shfrytëzim të përhershëm të pronës komunale për zgjerimin e varrezave të fshatit Uglarë, KK Gjilan

I

Me këtë vendim, komunitetit – banorëve të fshatit Uglarë, me qëllim të zgjerimit të varrezave të fshatit, Komuna e Gjilanit i jep në shfrytëzim të përhershëm paluajtshmerin P-70403061-00797-0 në sipërfaqe prej gjithsej 10.993 m², lloji i pronës-parcelë, zona rurale, shfrytëzimi aktual- kullosë e klasit të III-të, e cila në Çertifikatën mbi të Drejtat e Pronës së Paluajtshme, Lista e Njësive 165, evidentohet në emër të pronarit, Pasuri Shoqërore- Kuvendi i Komunës Gjilan.

II

Paluajtshmëria e cekur në pikën I të këtij vendimi nuk e ndryshon titullarin e pronës, pronar i saj mbetet Kuvendi Komunal i Gjilanit, por ndryshohet shfrytëzimi aktual: nga kullosë e klasit të III-të, shfrytëzimi i saj shëndrohet në "Varreza".

III

Rregullimi i këtyre varrezave, pastrimi i terenit, rrafshimi, vendosja e rrethojës, vendosja e hapësirave gjelbëruese, ndërtimi i një kthine për mjete doracake dhe mirëmbajtja e këtyre varrezave do të bëhet me vetkontributin e banorëve të fshatit në tersi sipas paraqitjes grafike të punuar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Gjilanit, e të cila do të jenë pjesë përbërëse e këtij vendimi.

IV

Autorizohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër, Pronë dhe Banim e KK-Gjilan, që në Regjistrat e të drejtave të Pronave të Paluajtshme ta bëjë ndryshimin e destinimit të kësaj parcele, dhe të shfrytëzimit aktual të saj siq është cekur në pikën II të këtij vendimi.

VI

Zbatimin e këtij vendimi e bënë Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër, Pronë dhe Banim, ndërsa për monitorimin e zbatimit kujdeset Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Gjilanit.

VII

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

01.Nr. 16/4338
Gjilan, më 29.03.2011

Kuvendi i Komunës,

/Izmi ZEKA, Kryesues/